



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.408/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hajriz Hoti dhe Ramush Bajriqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 09.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.408/2025, e datës 06.02.2025, e ushtruar kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 06.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër Anr.408/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë në të cilën pretendohet se më 04.02.2025 Kyetari i Degës së PDK-së për qytetin e Gjilanit, z.Riad Rashiti në tubimin elektorale të mbajtur nga kjo parti në qytetin e Gjilanit për qëllime politike ka përdorur gjuhë fyese. Shpifëse dhe denigruese ndaj kundërshtarëve politik përkatësisht Qeverisë së Republikës së Kosovës duke deklaruar *“Kjo qeverisje është tepër e dëmshme dhe me pasoja të mëdha për Rajonin tonë”*.

Si provë parashtresuesi i ankesës ka bashkangjitur CD nga video deklarimi.

Me datë 07.02.2025 PZAP iu drejtua me kërkesë për përgjigje subjektit politik PDK deri me datën 07.02.2025 në ora 19:00 .

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.02.2025 subjekti politik PDK e ka kundërshtuar si të pabazuar me pretendimin se fjalimi me tekst *“Kjo qeverisje është tepër e dëmshme dhe me pasoja të mëdha për Rajonin tonë”* nuk përmban gjuhë të urrejtjes pasi që diskursi i tillë i z.Riad Rashiti hyn në diskursin e fushatës zgjedhore.

Po ashtu parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka theksuar se PZAP me vendimin Anr.252/2025 ka konsideruar se deklarimi i z.Ramush Haradinaj se *“Cili është qëllimi i qeverisë që po shkon ose i këtij mashtruesi, a e dini cili është qëllimi, a ju ka treguar pashë zotin”* nuk e ka konsideruar se përben shkelje të rregullave zgjedhore.

Bazuar në të lartcekurat paneli ka gjetur se ankesa është e pabazuar.

Për faktin se pas shikimit të video incizimit të ofruar si prova materiale nga ankuesi, shihet Kyetari i Degës së PDK-së në tubimin elektoral të mbajtur nga kjo parti në qytetin e Gjilanit ku ka deklaruar *“Kjo qeverisje është tepër e dëmshme dhe më pasoja të mëdha për Rajonin Tonë”*, andaj sipas vlerësimit të panelit deklarimi i tillë është një paraqitje e një pikëpamje individuale të kandidatit dhe nuk shfaqë urrejtje si dhe nuk mund të quhet nxitëse andaj nuk bie në kundërshtim me nenin 34. Pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.”,

Paneli duke i vlerësuar këto deklarime të Kryetarit të Degës së PDK-së në qytetin e Gjilanit z.Riad Rashiti, Paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe të urrejtjes në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Fjalimet e tilla të përdorura nga mbështetësi i subjektit politik PDK konsiderohen se hynë në diskursin e fushatës zgjedhore, dhe nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon një person tjetër për të kryer një akt dhune kundër personave të tjerë ose pasurisë,

Andaj paneli vlerëson se deklarimet e lartcekura nga ana e kandidateve nuk konsiderohet se është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), e LZP-së, në të cilin nen përcaktohet se *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.408/2025, datë 09.02.2025

Kryesuesi i Panelit
Kujtim Rashiti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.